

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 581 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

VENDIM Nr. 45, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Orikos"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. As. Dr. Saimir Shpuza (IA), Prof. Jean Terrier (Universiteti i Gjenevës),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Orikos"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. As. Dr. Saimir Shpuza (IA), Prof. Jean Terrier (Universiteti i Gjenevës), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Muri rrethues
 - Nimfeu i qytetit
 - Zona e akropolit
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë maj- dhjetor 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO